

VENDIM
Nr.570, datë 5.9.2007

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË SHTETASIT AVNI HALIT DURIÇI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, grupi 25, titulli 10430, kap 1, artikulli 606 “Transferta të brendshme”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për dhënie ndihme të menjëhershme financiare familjes së shtetasit Avni Halit Duriçi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha